

## Politika e World Vision Shqipëri<sup>1</sup> për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Rriturve

### HYRJE:

- Kjo Politikë është krijuar në përputhje të plotë me Politikën Ndërkombëtare të WV për Menaxhimin, e autorizuar nga Politika e Ndërkombëtare për Mirëqenien e Fëmijëve dhe Politika e Ndërkombëtare mbi Kodin e Sjelljes, si dhe nga kuadri ligjor i shtetit Shqiptar që rregullon të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.
- Kjo Politikë bazohet në Poliktën e World Vision Internacional dhe quhet “Politika Ndërkombëtare e Menaxhimit të Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Fëmijëve dhe të Rriturve”, referruar gjithashtu edhe si “Politika e Menaxhimit të Mbrojtjes”, plotëson Standardet e WV për Mbrojtjen e Fëmijëve, e cila është aprovuar në 30 Gusht 2010 dhe është një zgjatim i Standarteve të World Vision për Mbrojtjen e Fëmijëve, që ekziston që prej vitit 2000. Kjo Politikë zvendëson “Politikën e World Vision në Shqipëri dhe Kosovë për Mbrojtjen e Fëmijëve” dhe është e përshtatur për kontekstin shqiptar.
- Kjo Politikë mbulon gjithë popullsitë vulnerabelë, sidomos gratë dhe fëmijët, në një politikë të vetme të integruar. Kjo Politikë vazhdon të theksojë vulnerabilitetet unike dhe kërkesat e posaçme për mbrojtje për fëmijët, bashë me rëndësinë e parandalimit të shfrytëzimit seksual dhe abuzimit (SHSA), në veçanti, mes formave të tjera të abuzimit të përfituesve nga të rriturit.
- Ruajtja dhe Mbrojtja e fëmijëve dhe të rriturve vulnerabelë të cilëve iu shërbejmë është themelore për të gjitha aktivitetet, programet, dhe Linjat e Shërbesës/Fokusit (Ndihmë, Zhvillim, Advokaci) e World Vision në Shqipëri (referruar këtu si WVA). Në thelb të cdo gjëje që bëjmë është përkushtimi që, së pari të mos lëndojmë fëmijët apo përfituesit e rritur, të respektojmë të drejtat e të gjithë përfituesve, si dhe të ruajmë interesat<sup>2</sup> më të larta të fëmijëve si parakusht në të gjitha veprimet dhe vendimet.
- Kjo Politikë është e bazuar në mandatin e gjerë të punës të WV – sidomos Mbrojtjen e Fëmijëve, shërbesë e cila ndërton kapacitetet e komuniteteve dhe forcon sistemet lokale dhe kombëtare që mbrojnë fëmijët.
- WV ka zero tolerancë ndaj incidenteve të dhunës apo abuzimit ndaj fëmijëve apo të rriturve, përfshi shfrytëzimin seksual dhe abuzimin, kryer qoftë nga punonjës të organizatës apo persona të tjerë të angazhuar me punën tonë. WV ndërmerr veprime të nevojshme për t’iu përgjigjur çfarëdo rasti të dyshuar apo të njohur abuzimi. Përgjigjet ndaj incidenteve, kanë në qendër fëmijën apo të rriturin e mbijetuar, duke iu dhënë përparësi interesave të tyre.
- WV është e përkushtuar për të përmirësuar vazhdimisht përpjekjet për mbrojtjen, e cila thekson parandalimin e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual (PSHAS) si dhe forma të tjera dhune apo lëndimi. Ne përpiqemi të trajtojmë rrënjët që shkakotjnë abuzimin përmes përpjekjeve tona për parandalim dhe trajnim.
- Kjo Politikë aplikohet dhe është kusht të zbatohet nga gjithë WVA dhe ata që i bashkohen organizatës: emigrantët, punonjësit kombëtare dhe të kontraktuarit, gjithë kategoritë e punonjësve duke përfshirë pa kushtëzim konsulentët, të kontraktuarit e pavarur, palët e dyta, punonjësit part-time dhe të përkohshëm, praktikantët dhe vullnetarët, në mënyrë që të adresohet risku i mbrojtjes që del nga anagazhimin i këtyre personave me WV.

### PËRKUFIZIME:

**Përfitues:** Në lidhje me Ruajtjen dhe Mbrojtjen, WV përdor një përkufizim të gjerë për termin ‘përfitues’ që përfshin jo vetëm përfituesit e drejtpërdrejtë të një projekti të caktuar, por edhe çdo fëmijë apo të rritur që mund të vuajë lëndim shkaktuar nga punonjës apo persona të angazhuar me WV si pjesë e pranisë/ekzistencës së programit të WV.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> Në kontekstin tone ligjor, Shqipëria dhe Kosova janë dy shtete të ndara dhe World Vision është regjistruar në të dyja shtetet respektive, prandaj politika do të përdore emrin World Vision si emer ligjor.

<sup>3</sup> Përkufizimi i World Vision njihë marrëdhëniet e pabarabarta të fuqisë midis një përfaqësuesi të OJF-je dhe komuniteteve vulnerabel.

**Fëmijë:** Çdo person nën moshën<sup>4</sup> 18 vjeç. Nëse mosha e personit nuk mund të përcaktohet qartë, por ka arsye të besohet që është fëmijë, ai/ajo do të trajtohet si fëmijë sipas Ligjit Nr.18/2017 Për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve, deri në momentin që përcaktohet mosha sipas ligjeve në fuqi. Politika e Menaxhimit për Ruajtjen dhe Mbrojtjen mbulon ndërveprime nga punonjës dhe persona të angazhuar me WV me të gjithë fëmijët kudo (jo vetëm përfituesit).

**Dhunë ndaj Fëmijëve:** është cdo veprim i qëllimshëm ose jo, përmes të cilit shkaktohet cdo lloj forme dhune fizike apo mendore, lëndim ose abuzim, neglizhim ose trajtim i pakujdesshëm, keqtrajtim ose shfrytëzim, përfshirë abuzimin seksual<sup>5</sup>

**Mbrojtja e fëmijëve:** Të gjitha masat e marra për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur abuzimit, neglizhencës, shfrytëzimit dhe të gjitha formave të tjera të dhunës kundër fëmijëve. Një sektor global i World Vision, bashkë me pjesëmarrjen e fëmijëve.

**Kontraktor:** WV kontraktin rregullisht individë që nuk janë punonjës të organizatës dhe organizata të tjera gjithashtu për të kryer shërbime për WV. Këtyre individëve që nuk janë punonjës dhe organizatave mund t'iu referohet edhe si 'kontraktorë të pavarur,' 'konsulentë,' apo 'ofruer' dhe iu referohet në këtë dokument si 'Kontraktorë.' Kontraktorët dallohen nga organizatat me të cilat WV është në partneritet për të zhvilluar aktivitet programor (përfshi nën-grantmarrësit). *Shih Partner, më poshtë.*

**Partner:** Një organizatë partnere, për qëllime të Ruajtjes dhe Mbrojtjes, është një Organizatë Jo-Qeveritare, Organizatë me Bazë Komunitare, sipërmarrje fitimprurëse, apo entitet tjetër që zbaton një program apo aktivitet në emër të WV apo në bashkëpunim me WV, dhe i cili ka një marrëveshje me shkrim me WV. Partneri mund të marrë ose jo financim nga WV.

**Ruajtja dhe Mbrojtja:** Parandalimi, raportimi dhe përgjigja ndaj lëndimit apo abuzimit të përfituesve të rritur dhe çdo fëmijë nga punonjës dhe persona të angazhuar me WV. Jashtë WV, zakonisht nuk bëhet dallim midis ruajtjes së fëmijëve dhe të rriturve.

**Ruajtja dhe Mbrojtja e fëmijëve:** Parandalimi, raportimi dhe përgjigja ndaj lëndimit,<sup>6</sup> abuzimit apo shfrytëzimit të çdo fëmijë (< 18 vjeç) nga një punonjës apo person i angazhuar me WV.<sup>7</sup> Politika e Menaxhimit të Ruajtjes dhe Mbrojtjes kërkon që të raportohen/referohen raste të abuzimit të fëmijëve që afektojnë çdo fëmijë në programet e WV, edhe nëse nuk është kryer nga punonjës apo persona të angazhuar me WV.

**Ruajtja dhe Mbrojtja e të rriturve:** Parandalimi, raportimi dhe përgjigja ndaj lëndimit, abuzimit ose shfrytëzimit të një përfituesi të rritur (mosha 18+) nga një punonjës apo person i angazhuar me WV.<sup>8</sup> Përfshin Parandalimin e Shfrytëzimit Seksual dhe Abuzimit (PSHSA), një nën-ndarje e cituar shpesh për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e personave.

**Incident me Ruajtjen dhe Mbrojtjen:** *Shih Seksioni 6.1.*

**Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi (SHSA):** Termi "shfrytëzim seksual" nënkupton çdo abuzim faktik apo të tentuar ndaj një personi të cënueshëm, të pafuqishëm, për qëllime seksuale, përfshi, por jo e kufizuar vetëm në, përfitim monetar, social, apo politik nga shfrytëzimi seksual i dikujt tjetër. Termi "abuzim seksual" nënkupton këcënimin për ndërhyrje fizike apo ndërhyrjen fizike të ndodhur të një natyre seksuale, qoftë me forcë apo në kushte të pabarabarta apo shtrënguese.<sup>9</sup>

**Parandalimi i Shfrytëzimit Seksual dhe Abuzimit (PSHSA):** Një term i përdorur nga Kombet e Bashkuara dhe komuniteti i Organizatave Jo-Qeveritare Ndërkombëtare për t'iu referuar masave të marra për të mbrojtur personat vulnerabël nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual nga punonjës ndihmash humanitare.

<sup>4</sup> Neni 3, 4 I ligjit Nr 18/2017 për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve

<sup>5</sup> Neni 3, 3 I ligjit Nr 18/2017 për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve

<sup>6</sup> Përfshin lëndim apo vdekjen e një fëmijë ndërsa merr pjesë në një nga aktivitetet e WV ose kur është i përfshirë në një aksident me një mjet të WV ose shofer të WV.

<sup>7</sup> Përfshin punonjës, vullnetarë, praktikantë, anëtarë bordi, vizitorë, të kontraktuar ose partnerë të WVA. Gjithashtu përfshin punonjës ose të nenkontraktuar të partnereve, ose punonjës/ të nenkontraktuar të kontraktoreve.

<sup>8</sup> Ibid

<sup>9</sup> Buletini I Sekretarit të Përgjithshëm të UN në lidhje me mbrojtjen nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi.

**Vullnetar:** Një person që as nuk është punësuar nga WV dhe as ka detyrim ligjor të punojë për WV, por që me vullnet të lirë dhe pa pritshmëri për pagesë apo shpërblim tjetër, kontribuon kohë, aftësi, dije, përpjekje dhe ekspertizë për punën e WV. 'Vullnetar' përfshin një 'vullnetar biznesi' në një zyrë apo degë të WV; një 'vullnetar mbështetës' pa kontakt fizik të drejtpërdrejtë me fëmijë të sponsorizuar apo të dhënat e tyre; 'vullnetar komunitar' që punon vullnetarisht në emër të komunitetit për të përmbushur përgjegjësitë e komunitetit në një projekt në zbatim e sipër të WV; dhe vullnetarë apo 'punonjës nxitës' nga grupe a komunitete të targetuara për ndihmë humanitare. Të gjitha kategoritë e vullnetarëve i nënshtrohen Politikës për Menaxhimin e Ruajtjes, përveç vullnetarëve komunitarë për të cilët kanë vlerë këto më poshtë:

- a) Vullnetari komunitar nuk ka kontakt fizik me fëmijë të sponsorizuar apo të dhënat e tyre si pjesë e aktiviteteve të tij vullnetare;
- b) Përtej trajnimit bazë, WV nuk specifikon mënyrën se si kryen aktivitetet përkatëse; DHE
- c) Komuniteti nuk e percepton apo konsideron këtë person si 'pjesë të punës së WV' për shkak të aktiviteteve të tyre vullnetare, dhe nëse do të lëndonin një fëmijë apo të rritur, nuk do të priteshin që t'i kërkonin llogari WV.

**Punonjës dhe persona të cilet angazhohen me WV:** I referohet gamës së plotë të gjithë personave përgjegjës dhe që mbahen të përgjegjshëm për Politikën dhe Protokollet e WV për Ruajtjen, përfshi të gjithë punonjësit, stazhierët, vullnetarët, dhe anëtarët e Bordit Këshillimor, si dhe palë të jashtme, përfshi vizitorë, vullnetarë komunitarë, kontraktorë, partnerë dhe të tjerë të lidhur me partnerë apo kontraktorë.

## **POLITIKA:**

### **I.0 Politikën dhe Përgjegjësitë për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Fëmijës.**

- I.1 Zhvillimi i Politikave të Kontekstualizuara të Ruajtjes dhe Mbrojtjes: WVA ka përgjegjësi për t'u siguruar për zhvillimin, zbatimin dhe rishikimin periodik të Politikës së saj për Ruajtjen dhe Mbrojtjen, e cila duhet të jetë konsistente me standartet e Politikës Ndërkombëtare të World Vision International për Menaxhimin e Protokolleve të Ruajtjes dhe Mbrojtjes të Fëmijëve dhe të Rriturve dhe duhet të jete në përputhje me ligjet e shtetit Shqiptar që merren me çështje të mbrojtjes dhe të drejtave të fëmijëve dhe të rriturve. Detyrimet dhe kërkesat e kësaj Politike Kombëtare për Ruajtjen dhe Mbrojtjen janë në përputhje me kontekstin dhe ligjet kombëtare.
- I.2 Personat nga WVA dhe personat që angazhohen me WVA për të cilët kjo Politikë është e vlefshme: WV i përgatit të gjithë punonjësit, praktikantët, vullnetarët dhe anëtarët e Bordit Këshillimor për të kuptuar dhe ushtruar përgjegjësitë dhe detyrimet e tyre që lidhen me Ruajtjen dhe Mbrojtjen. WV po ashtu aplikon standarde të përshtatshme për palë të jashtme, përfshi vizitorë, vullnetarë komunitarë, kontraktorë, partnerë dhe të tjerë lidhur me partnerë a kontraktorë, për të trajtuar rreziqe që lidhen me Ruajtjen dhe Mbrojtjen për shkak të angazhimit të tyre me punën e WV. Nga ky çast, gamës së plotë të personave të cilëve iu aplikohet një pjesë apo e gjithë Politika (drejtpërdrejt apo nëpërmjet rregullimeve kontraktuale), do t'i referohet si 'punonjës dhe/ose persona të angazhuar me WV.'
- I.3 Ndërgjegjësimi: Të gjithë punonjësit, vullnetarët, praktikantët, dhe anëtarët e Bordit Këshillimor të WV nënshkruajnë një dokument pranimi se e njohin, kuptojnë dhe do ta ndjekin këtë Politikë të Menaxhimit të Ruajtjes dhe Mbrojtjes. Dakordësimet e nënshkruara ruhen në dosje nga zyra e WVA (stafi i Burimeve Njerëzore, Zyra e Komunikimeve dhe Marketingut për Marrëdhënie me Publikun dhe për produkte/aktivitete Marketingu, Departamenti i Prokurimit të të mirave dhe shërbimeve, Operacionet dhe Sponsorshipi për vizitorët në terren).
- I.4 Marrëveshjet me Kontraktorë: Kontraktorët e përfshirë në situata ku ata – apo punonjësit a nënkontraktorët e tyre – mund të kenë akses tek përfituesit fëmijë apo të rritur në programet e WV, ose mund të kenë akses në të dhëna personale për të tillë fëmijë apo përfitues të rritur, kërkohet të kenë gjuhën e mëposhtme për çështje që lidhen me Ruajtjen e fëmijëve dhe të rriturve sipas kontratës që ata kanë me WVA. Gjithashtu, kontratës i duhet bashkëngjitur një kopje e Protokolleve të Sjelljes për Ruajtjen dhe Mbrojtjen. Këto kërkesa kanë vlerë si kur Kontraktori paguhet për shërbimet, ashtu edhe kur i ofron ato falas ('pro bono'), si dhe pavarësisht nga kohëzgjatja e kontratës.

'Gjatë kohës së përmbushjes së kësaj kontrate, Kontraktuesi dhe punonjësit e Kontraktuesit duhet të sigurojnë që:

1. Çdo ndërveprim i tyre me fëmijë apo përfitues të rritur, apo me të dhëna personale të këtyre personave, duhet t'iu përmbahet Protokolleve të WV për Sjelljen për Ruajtjen dhe Mbrojtjen, si dhe me masave të tjera të arsyeshme për Ruajtjen dhe Mbrojtjen që mund të specifikohen nga WV;
2. Çfarëdo incident lëndimi apo rreziku ndaj fëmijëve apo përfituesve të rritur duhet t'i raportohen menjëherë WV;
3. Çdo individ me akses tek fëmijët apo përfituesit e rritur, apo tek të dhënat personale të këtyre personave, duhet të kenë një kartelë të pastër të Dëshmisë së Penalitetit për kundrvajtje ndaj fëmijëve apo abuzimit ndaj të rriturve, në masën e lejuar nga ligji (prova që i duhen vënë në dispozicion WV nëse iu kërkohet); dhe
4. Këto detyrime për Ruajtjen dhe Mbrojtjen i duhen komunikuar qartë dhe duhen pranuar nga të gjithë punonjësit që mund të kenë akses tek fëmijët apo përfituesit e rritur, apo tek të dhënat personale të këtyre personave, si dhe do të aplikohen po njësoj tek çdo nënkontraktor tjetër (nëse janë autorizuar të tillë) që angazhohen për përmbushjen e kësaj kontrate.'

I.5 Marrëveshje me Organizata Partnere: Kur angazhohet një partner për një program të WV apo aktivitet të programit, marrëveshja (pavarësisht nëse i referohet me termin 'marrëveshje,' 'nën-grant,' 'Memorandum Mirëkuptimi,' apo ndonjë term tjetër), specifikon se, përpara se Partneri të fillojë çfarëdo punë apo angazhimi për projektin e WV, duhet që më përpara t'i jepet Politika dhe Procedurat e Partnerit për Ruajtjen dhe Mbrojtjen dhe duhen miratuar nga WV sipas rastit për programet në fjalë. Më pas, Partneri mund të bjerë dakord që të ndjekë Politikën e WV për Ruajtjen dhe Mbrojtjen gjatë zbatimit të aktiviteteve të programit. Marrëveshja duhet të sigurojë që cilido anëtar i personelit të Partnerit që punon në projektin e WV duhet të ketë një Dëshmi të pastër Penaliteti aktuale për kundrvajtje ndaj fëmijëve apo abuzim ndaj të rriturve, deri në masën e lejuar nga ligji (prova që i duhen dorëzuar WV sipas kërkesës).

I.6 Trajnimi: Të gjithë punonjësit, vullnetarët, praktikantët dhe anëtarët e Bordit/ Këshillit Këshillimor të WV, si dhe punonjës të partnerëve apo vullnetarë të partnerëve që punojnë brenda një projekti të WV, duhet të marrin trajnim për Ruajtjen dhe Mbrojtjen në fillim të punësimit apo lidhjes/angazhimit me WV. Punonjësit dhe vullnetarët e WV marrin trajnim rinfreskues apo trajnim tjetër për Ruajtjen dhe Mbrojtjen të paktën një herë çdo dy vjet pas këtij trajnimi.

I.7 Personeli/stafi që nevojitet për Ruajtjen dhe Mbrojtjen: WVA ka caktuar një Person Drejtues/Kontakti për Ruajtjen dhe Mbrojtjen për të drejtuar zbatimin e kësaj Politike. Ky person ka në madatin e vet, akses të drejtpërdrejtë te Drejtori Kombëtar i WVA, Drejtuesi Rajonal i Ruajtjes dhe Mbrojtjes dhe te Drejtori i World Vision International për Ruajtjen dhe Mbrojtjen në rast se ai/ajo ndjen që çështjet që lidhen me Ruajtjen dhe Mbrojtjen nuk po adresohen në mënyrën e duhur.

## 2.0 Protokollat e Sjelljes

Protokollet e Sjelljes për Ruajtjen dhe Mbrojtjen: Punonjësit dhe personat e angazhuar me WV sillen në mënyra të tilla që mbrojnë fëmijë dhe përfituesit e rritur, parandalojnë shfrytëzimin seksual dhe abuzimin, si dhe parandalojnë ndonjë lëndim tjetër të qëllimshëm apo pa dashje ndaj njerëzve të cilëve WVA iu shërben apo mes të cilëve punon. WVA kërkon që të gjithë personat e sipërpërmendur të njihen dhe të pranojnë me shkrim Politikën për Menaxhimin e Ruajtjes dhe Mbrojtjes, duke shprehur kështu të kuptuarin e tyre për këtë Politikë, firmosja e së cilës duhet mbajtur në mënyrën e duhur në dosje në zyrat relevante të WVA. Protokollin Kombëtar i Sjelljes hartohet duke ndjekur Protokollin e Sjelljes të World Vision International. Të gjithë punonjësit e WVA dhe të gjithë ata që angazhohen me WVA në aktivitete dhe programe, duhet t'i binden kësaj Politike kur ndërveprojnë me fëmijë dhe përfituesit e rritur.

**Sjellja e Pranueshme**<sup>10</sup> – Punonjës të WV dhe persona të angazhuar me WV:

- a) krijojnë dhe sillen në mënyrë të atillë që parandalon shfrytëzimin seksual dhe abuzimin e fëmijëve dhe përfituesve të rritur dhe promovojnë zbatimin e këtyre Protokolleve të Sjelljes;
- b) janë të kujdesshëm lidhur me perceptimin dhe gjuhën që përdorin, veprimet dhe marrëdhëniet e tyre me fëmijët dhe personat vulnerabël. Sjellja e tyre – përfshi ballë për ballë dhe në platforma digjitale, si online ashtu edhe offline – demonstroi respekt për fëmijët dhe përfituesit e rritur dhe është në përputhje me ligjet e vendit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve;

<sup>10</sup> Pershtatur ne perputhje me ligjin e shtetit shqiptar Nr 18/2017

- c) sigurohen që të gjitha kontaktet fizike dhe online me fëmijët dhe përfituesit të jenë të përshtatshme në kulturën e vendit dhe në përputhje me ligjet e vendit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve ;
- d) përdorin metoda pozitive jo të dhunshme për të menaxhuar sjelljen e fëmijëve;
- e) pranojnë përgjegjësinë për sjelljen dhe veprimet personale si përfaqësues të organizatës;
- f) japin gjithmonë llogari për mënyrën si përgjigjen ndaj sjelljes dhe veprimeve të fëmijëve, edhe nëse një fëmijë sillet në mënyrë seksualisht të papërshtatshme; të rriturit ndalohen të vendosen në një pozitë kompromentuese apo vulnerabël (që i cënon) me fëmijët;
- g) ku është e mundur dhe e zbatueshme, ndjekin rregullin e 'dy të rriturve' teksa kryejnë punë të WV, ku dy a më shumë të rritur mbikqyrin të gjitha veprimtaritë që përfshijnë fëmijët dhe janë të dukshëm dhe të pranishëm në çdo kohë;
- h) respektojnë hetimet (e brendshme dhe të jashtme) të lidhura me Ruajtjen dhe Mbrojtjen dhe vënë në dispozicion çdo informacion të dokumentar apo lloji tjetër të nevojshëm për përfundimin e hetimit;
- i) respektojnë të gjitha ligjet përkatëse për privatësinë e të dhënave si dhe politikat përkatëse të WV për privatësinë e të dhënave dhe sigurinë e informacionit, përfshi protokollat digjitale të WV për ruajtjen e fëmijëve, kur trajtojnë ndonjë të dhënë personale për fëmijët apo përfituesit e rritur dhe se të tilla të dhëna duhen ruajtur dhe transferuar në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale;
- j) raportojnë menjëherë nëpërmjet mekanizmave të ngritura të raportimit çfarëdo incidenti të njohur apo të dyshuar, a shkelje të kësaj Politike nga një punonjës i WV apo person i angazhuar me WV, apo punonjës ndihmash humanitare<sup>11</sup> nga ndonjë agjenci tjetër (*Shih Seksioni 6.5.1 mbi mënyrën e raportimit*).

### **Sjellja e Papranueshme<sup>12</sup> – Punonjësit e WVA dhe personat lidhur me WVA nuk duhet:**

- a) Të sillen në mënyrë fizike të papërshtatshme, apo të zhvillojnë një marrëdhënie seksuale me një fëmijë (nën 18 vjeç), pavarësisht nga mosha ligjore specifike për pëlqimin që parashikon ligji I vendit. Kjo përfshin edhe pëlqimin apo mbeshtetjen për birësimin apo martesën e fëmijëve nën 18 vjeç.
- b) Të zhvillojnë apo kërkojnë marrëdhënie seksuale me çfarëdo përfitues të çdo lloji moshe; marrëdhënie të tilla nuk janë të pranueshme dhe nuk do të tolerohen sepse bazohen në marrëdhënie pushteti të pabarabarta. Marrëdhënie të tilla çenojnë besueshmërinë dhe integritetin e ndihmës humanitare apo punës zhvillimore të WV;
- c) Të shfrytëzojnë apo të abuzojnë seksualisht ndonjë përfitues (të rritur ose fëmijë); Një sjellje e tillë përbën akt shkeljeje të rëndë;
- d) Të shkëmbejnë para, punësim, mallra apo shërbime për seks (përfshi favour seksuale, forma të tjera sjelljeje poshtëruese, degraduese apo shfrytëzuese, apo të marrin punëtorësh seksi me pagesë) apo kërkesa të tjera shfrytëzuese janë të ndaluara në mënyrë kategorike.
- e) Të perkëdhelin, të mbajnë, të puthin, të përqafojnë apo të prekin përfitues fëmijë apo të rritur në mënyrë të papërshtatshme apo kulturalisht jo të pranueshme.
- f) Të përdorin gjuhë, sugjerojnë apo ofrojnë këshilla për një përfitues fëmijë apo të rritur që është e papërshtatshme apo abuzive, përfshi gjuhë që shkakton turp, poshtërim, tallje apo degradim.
- g) Të kalojnë kohë të tepërt a të panevojshme vetëm me një përfitues fëmijë apo të rritur, larg nga të tjerët, me derë mbyllur apo në një hapësirë të veçuar;
- h) Të përkrasin apo të marrin pjesë në sjellje me përfitues fëmijë apo të rritur që është e jashtëligjshme, e pasigurt ose abuzive; përfshi praktika të dëmshme ose abuzim shpirtëror;
- i) Të punësojnë fëmijë (përfshirë edhe si 'ndihmës në shtëpi') përveç rasteve kur është brenda interesave më të mira të fëmijës dhe në përputhje me ligjin vendas të mbrojtjes së fëmijëve dhe praktikat ndërkombëtare të Kodit të Punës ('Puna e fëmijëve' është punë që është e rrezikshme dhe e dëmshme mendërisht, fizikisht, shoqërisht apo moralisht për fëmijët, apo që pengon shkollimin e tyre. Shiko nenin 182 dhe 138 të Konventës së Organizatës Nderkombëtare të Punës ILO. "Puna për fëmijë" nga ana

<sup>11</sup> "Punonjës ndihmash humanitare" përfshin të gjithë punonjësit e paguar, vullnetarët, kontraktorët a persona të tjerë lidhur me organizata që ofrojnë ndihma humanitare apo ndihmës zhvillimore. Organizata të tilla përfshijnë agjencitë e OKB-së, OJQN, OJQV dhe OBK.

<sup>12</sup> Nje seri sjelljesh nga ky protokoll jane pershtatur sipas ligjit Nr 18/2017

tjetër mund të jetë përfituese nëse lejohet nga Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) dhe vë interesat e fëmijëve përpara çdo përfitimi përfituar nga të rriturit.<sup>13</sup>);

- j) Të godasin apo përdorin dënime të tjera trupore ndaj një fëmije ndërkohë që fëmija është nën kujdesin e WV apo kur punonjësi i WV ose personi lidhur me WV po kryen punë të WV;<sup>14</sup> Të marrin një fëmijë vetëm në një automjet, për punë të WV, përveçse kur është absolutisht e nevojshme, me pëlqimin e prindit/kujdestarit dhe menaxherit të programit.<sup>15</sup>
- k) Të marrin në një makinë të WVA një fëmije, përveç rasteve kur është e domosdoshme dhe me lejen e prindit apo kujdestarit ligjor.
- l) Të keqpërdorë apo të jetë i pakujdesshëm me të dhënat personale të fëmijëve apo të rriturve përfitues.
- m) Të komunikojnë me fëmijë në zonat e programit të WV nëpërmjet platformave digjitale (p.sh. Facebook, Twitter), teknologjisë së lëvizshme (p.sh. sms, Whatsapp, Skype), apo online pa pëlqimin dhe dënimin e prindërve të tij/saj. Për më tepër, punonjësit apo personat e lidhur me WV kurrë nuk duhet të komunikojnë në telefona celularë, platforma digjitale apo online me përfitues fëmijë apo të rritur në mënyra që janë të papërshtatshme apo seksuale;
- n) Të heshtin, të mbulojnë apo të mundësojnë ndonjë incident të dyshuar lidhur me shkeljen e Politikës së Ruajtjes dhe Mbrojtjes nga ndonjë punonjës i WV ose person i lidhur me WV.

2.1.1 Çdo person i angazhuar me WV që nuk i kërkohet të nënshkruajë Politikën e Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Fëmijëve (Shiko seksionin 1.3) duhet minimalisht të nënshkruajë njohjen dhe kuptimin e kësaj politike së bashku me protokollet e saj.

2.2 **Masat Disiplinore:** Mos zbatimi i Protokolleve të Sjelljes; mos respektimi i pjesëve të kësaj politike; sjellje të tjera të papërshtatshme ndaj fëmijëve ose të rriturve përfitues; apo mos raportimi i incidenteve të njohura/ të dyshuara kryer nga një punonjës ose person i angazhuar me WV, përbën bazë për marrjen e masave disiplinore, deri në ndërprerjen e punësimit apo cdo lidhje tjetër me WV.

### 3.0 Rekrutimi

3.1 **Kontrolli<sup>16</sup>:** WV ndërmerr masa për të kontrolluar të gjithë personat që mund të kërkojnë të përdorin emrin e organizatës për të lënduar fëmijët ose të rriturit përfitues, apo veprimet e të cilëve në të kaluarën tregojnë rreziqe të papranueshme për lëndim të tillë. Këto masa përfshijnë prezantimin e Politikës së Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Fëmijëve në njoftimet e punës, aplikime, intervista dhe referenca. Masat e kontrollit aplikohen ndaj të gjithë kandidatëve për punësim, anëtarëve të Bordit Këshillues, vullnetarë, praktikantë dhe kontraktues individualë që do të kenë akses me përfitues fëmijë apo të rritur apo të dhënat e tyre personale. Gjatë procesit të intervistimit, aplikantët pyeten për punën e tyre të mëparshme me fëmijët. Për referencat e paraqitura nga aplikantët, bëhen pyetje lidhur me përshtatshmërinë e kandidatit për të punuar me të rritur dhe fëmijë vulnerabel ose për një agjenci që ka në fokus fëmijët. Dokumentimi i referencave ruhet në dosje nga Departamenti Njerëz dhe Kultura.

3.2 **Kontrolli i identitetit dhe historikut ligjor:** Kandidatëve për punësim, anëtarëve të Bordit Këshillues, vullnetarë, praktikantë, si dhe personelit përkatës të kontraktore dhe partnere, iu kryhet kontrolli i identitetit dhe dëshmia e penaltetit përpara punësimit apo angazhimit me WV, si dhe më pas në mënyrë periodike sipas kërkesave ligjore apo nevojës. Personat me dënime të mëparshme për çfarëdo krimi kundër fëmijëve apo shfrytëzim dhe abuzim seksual ndaj një të rrituri nuk punësohen dhe as angazhohen nga WV, deri në masën e lejuar nga ligji përkatës, dhe në çdo rast, nuk do të vendosen në pozicione me

<sup>13</sup> "Punësimi i fëmijës" mund të rezultojë përfituese nëse lejohet nga Organizata Ndërkombëtare e Punësimit, Konventat dhe vendos interesat e fëmijës përpara çdo përfitimi apo interesi të të rriturve.

<sup>14</sup> Ndeshkimi trupor është cdo lloj forme ndeshkimi në të cilin përdoret forcë fizike për të shkakuar dhimbje apo mosrehati për fëmijën, nga cdo person që është ligjerisht përgjegjës për këtë fëmijë. Ndeshkimi trupor përfshin këto forma: pickim, tortura, shkundje, të djegur, të shtyra, shuplaka, të kafshuara, të gërvishura, shkulje flokesh, sharje, detyrim për të bërë dicka, përdorim i substancave që shkaktojnë dhimbje dhe cdo lloj akti tjetër të ngjashëm. Artikulli 3/9 i ligjit Nr 18/2017.

<sup>15</sup> Gjithë punonjësit e WVA janë të familjarizuar me menyrat alternative që zevendesojnë ndeshkimin trupor, përfshirë qasjet e prindërimit pozitiv të cilat supozohen të aplikohen me fëmijë Brenda dhe jashtë vendeve ku WV punon.

<sup>16</sup> Kini parasysh që donator të ndryshëm të granteve mund të kenë kërkesa të vecanta për pjesën që ata mbulojnë me fonde, kështu që duhet të kontrollohen dhe të validohen termit e duhur të granteve.

akses ndaj përfituesve fëmijë apo të rritur dhe te dhënave të tyre personale.

#### 4.0 Vizitat në projektet e WVVA

**4.1 Vizitorët:** Vizitorët që i nënshtrohen kësaj Politike përfshijnë persona që shkojnë në një program rajonal apo takim të WV ku ndodhen fëmijë. Kjo përfshin sponsorë, donator dhe delegacione të tjera nga Zyrat Mbështetëse të tillë si blogera, figura publike, apo gazetarë të ftuar nga WV. Zyrtarët qeveritarë apo donatorët institucionalë qeveritare ose shumëpalëshe, me qendër në vendin pritës, NUK është e nevojshme të firmosin politikën, por të shoqërohen nga punonjës i/të WV.

**4.2 Përgatitja e vizitave:** Vizitat nga të gjithë sponsorët dhe donatorët privatë, si dhe vizitorët e tjerë ndërkombëtarë miratohen paraprakisht nga zyra dërguese dhe pritëse. Zyrat Mbështetëse dhe Zyrat Rajonale me programe Zhvillimore Burimore Kombëtare kryejnë kontrolle policore të historikut për vizitorët e mundshëm sponsorë apo donatorë përpara ndonjë vizite në terren, aty ku lejohet nga ligji. Vizitat e panjoftuara tek fëmijët e sponsorizuar apo komunitetet e projekteve të WV nuk lejohen.

**4.3 Orientimi i vizitoreve për politikën:** Çdo entitet i WV është rigoroz për të siguruar që vizitorët respektojnë seksionet përkatëse të kësaj Politike. Kërkesat e mëposhtme janë të vlefshme për vizitorët që vizitojnë një projekt apo kanë kontakte të ndryshme me anëtarë të komuniteteve në programet rajonale të WV.

a) Vizitorët nga zyra të tjera të WV që janë punonjës apo Anëtarë Bordi: Zyra pritëse ofron një orientim të shkurtër mbi Politikën e Ruajtjes dhe Mbrojtjes si dhe Protokollet e Sjelljes të posaçme që aplikohen në atë kontekst, si dhe praktika kulturore lidhur me ndërveprimin e të rriturve me fëmijët.

b) Vizitorët që nuk janë punonjës të WV apo Anëtarë Bordi: Të gjithë këtyre vizitorëve iu jepet një përmbledhje mbi Protokollet e Sjelljes (*Seksioni 2.1*) dhe Parandalimi i Lëndimit në Komunikime (*Seksioni 5.4*) nga zyra dërguese përpara vizitës. Pas arritjes, vizitorëve iu jepet një orientim i shkurtër me shkrim ose gojë dhe nënshkruajnë njohjen e protokolleve. Pranimi me shkrim ruhet në dosje nga enti pritës. Këta vizitorë shoqërohen gjithmonë nga një punonjës i WV kur vizitojnë projektet.

#### 5.0 Komunikimet, Media Sociale dhe Teknologjia Digjitale

**5.1 Dinjiteti:** WV kujdeset për t'u siguruar që respektohen traditat apo kufizimet vendase për riprodhimin e imazheve personale përpara fotografimit apo filmimit të një subjekti dhe WV sigurohet që imazhet janë përfaqësime të ndershme të kontekstit dhe fakteve. Në të gjitha format e komunikimit, përfituesit fëmijë dhe të rritur trajtohen dhe portretizohen me dinjitet dhe jo si viktimë të pashpresa apo në poza të papërshtatshme seksuale.

**5.2 Miratimi/pëlqimi:** Përfituesit fëmijë apo të rritur që janë subjekte parësore të grumbullimit të burimeve me tekst, foto dhe/ose video nga punonjësit e WV duhet të japin pëlqim të informuar. Pëlqimi i informuar nënkupton se subjekti kupton përgjithësisht qëllimin e raportimit apo fotografisë, dhe jep leje me gojë apo me shkrim për të. Nëse subjekti parësor është fëmijë, pëlqimi i informuar merret nga prindi, kujdestari, apo një individ ligjërisht i lejuar. Në situatat e mëposhtme, pëlqimi me shkrim merret nga fëmija (sipas përshtatshmërisë së moshës) apo i rrituri:

a) një fëmijë/ i rritur përfitues mund të identifikohet personalisht.

b) natyra sensitive e publikimit të të dhënave të tyre personale apo situatë që mund të shkaktonin dëmtim të privatësisë, dinjitetit, sigurisë apo reputacionit.

c) Kur kërkohet nga ligji në fuqi.

**5.3 Ndërgjegjësimi Dixhital:** WV mbështet në mënyrë aktive Fëmijët e Regjistruar (FR) dhe prindërit/kujdestarët e tyre, si dhe ndonjë fëmijë që merr pjesë në veprimtari të organizuara nga WV për Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK); për të kuptuar se si të përdoret në mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme media sociale dhe teknologjia dixhitale, ndërkohë që shmangen rreziqet duke iu përgjigjur si duhet kërcënimeve apo incidenteve.

**5.4 Parandalimi i Lëndimit në Komunikime:** WV është i përkushtuar ndaj rrëfimit të historive që rrit ndërgjegjësimin dhe promovon zgjidhje për t'i dhënë fund dhunës dhe abuzimit kundër fëmijëve dhe të rriturve përfitues. WV ndërmerr hapat e mëposhtëm për të parandaluar lëndim nëpërmjet komunikimit, medias sociale dhe teknologjisë dixhitale (përfshi foto/ video/ pjesë audio, histori, artikuj apo materiale të tjera komunikimi):

a) Informacioni personal që merret për përfitues fëmijë apo të rritur, ruhet apo dërgohet nëpërmjet pajisjesh elektronike, online apo me celular ruhet me fjalëkalim. Gjithashtu, të dhënat trajtohen në përputhje me standardet

e sigurisë së informacionit të WV për të dhënat personale, të cilat mund të përfshijnë enkriptimin apo kërkesa të tjera.

b) Aty ku është e mundur, merren masa për të parandaluar kopjimin elektronik të fotove pa lejen e WV (duke përdorur Watermark digjitale dhe çaktivizim të funksionit të butonit të djathtë të mouse-it në përputhje me Standardet Minimale të Partneritetit të WV për Pranimë në Internet).

c) Duke pranuar vulnerabilitetin e posaçëm të fëmijëve, materialet e postuara në median sociale apo teknologji digjitale nuk duhet të përmbajnë mbiemrin e fëmijës, numrin ID të sponsorizimit, apo vendndodhjen/adresën personale të fëmijës.

d) Materialet me një ose disa fëmijë nuk përmbajnë të dhëna gjeografike apo vendndodhje të sakta nëse përmbajnë ndonjë pjesë të emrit të fëmijës. Një alternative e pranueshme është lidhja (tag) e fotove me emrin e fëmijës vetëm me vendndodhjen e Zyrës Rajonale apo zyrës së projektit.

e) WV shkurruron komunikimin e drejtpërdrejtë, të pandërmjetësuar, të padokumentuar nëpërmjet medias sociale pa njohurinë e WV midis: një sponsori/donator/vizitori dhe fëmijëve të regjistruar/paregjistruar dhe midis punonjësve/vullnetarëve/personave të tjerë lidhur me WV dhe fëmijë të regjistruar/paregjistruar.

f) WV ofron raportim dhe mundësi përgjigjeje në mënyrë që sponsorët, donatorët, vizitorët, apo kujdestarët e tyre të mund të raportojnë çdo incident ku secila prej palëve ndihet në siklet apo e kërcënuar.

g) paketat e mirësearchjes për sponsorizimet, faqet e internetit të WV, domenet dhe faqet e profileve të mediave sociale përmbajnë mundësi raportimi për shqetësime apo incidente që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve.

**5.5 Raportimi për thyerjen e politikës të komunikimeve, medias sociale dhe teknologjive dixhitale:** Të gjitha thyerjet e kësaj politike duhet të raportohen tek Drejtuesi Rajonal i Politikës së Ruajtjes dhe Mbrojtjes ose Drejtori Ndërkombëtar i Politikës së Ruajtjes dhe Mbrojtjes. Përgjigja ndaj kësaj shkelje bazohet në peshën dhe ashpërsinë e rrezikut ndaj fëmijëve dhe të rriturve përfitues.

## **6.0 Incidentet e mbrojtjes dhe Protokollin e përgjigjeve ndaj incidenteve.**

**6.1 Përgjigja ndaj incidenteve të mbrojtjes:** WVA investigon dhe përgjigjet ndaj raportimeve të abuzimit për fëmijët dhe të rriturit përfitues, në mënyra që janë të parashikuara edhe në ligjin kombëtar për mbrojtjen ndaj dhunës dhe të drejtat e fëmijëve. WVA përdor tre nivele për t'ju përgjigjur incidenteve të mbrojtjes, të cilat janë të bazuara në seriozitetin e incidenteve dhe rolin e WVA.

**6.2 Niveli 1. Incident i Mbrojtjes së Fëmijëve në komunitet:** Abuzim ose lëndim të një fëmije, në një komunitet ku WVA zbaton programet e saj, por që nuk është kryer nga punonjës të WVA ose njerëz të lidhur me të. Personi i kontaktit për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e raporton Nivelin I të incidentit tek Njësia Ndërkombëtare e Ruajtjes dhe Mbrojtjes në rastet e lëndimeve të rënda që kërcënojnë fëmijën për jetën e tij, sigurinë dhe zhvillimin. Zyra Kombëtare zbaton Planin Paraprak të Incidenteve të Mbrojtjes, i cili përmban udhëzime praktike mbi përgjegjësitë, veprimet dhe kufizimet që duhen ndjekur, në përputhje me ligjin lokal, skuadra lokale ku ka ndodhur incidenti.

**6.3 Niveli 2:** Një incident i Nivelit të dytë është shkelja e kësaj politike e cila vendos në rrezik dirket ose lëndim potencial fëmijën ose të rriturin përfitues, por që ky lëndim nuk ka ndodhur realisht. WVA raporton incidente të nivelit të dytë brenda 24 orëve nga njoftimi. Përgjigja zbatohet nga WVA me mbikëqyrje dhe përgjegjësi nga Drejtori i Mbrojtjes së WV dhe mbështetje nga Drejtuesi Rajonal i Mbrojtjes.

**6.4 Niveli 3:** Një Incident i nivelit të tretë është një pretendim ose akuzë për dëmtim ose abuzim ndaj një fëmije ose përfituesi të rritur nga një punonjës ose bashkëpunëtor i WVA. Nëse një fëmijë është i përfshirë, janë konsiderohen dy lloje të incidenteve: vdekje dhe dëmtime serioze të një fëmije, ndërkohe që është duke marrë pjesë në një aktivitet të WVA ose i shkaktuar direkt nga një person i lidhur me WVA, dhe/ose i përfshirë në një aksident rrugor nga makinat e WVA ose shoferi i WVA. Të gjitha stafet e WVA raportojnë nivelin e tretë të incidentit brenda 24 orëve nga njoftimi i parë. Përgjigja zbatohet nga WVA me mbikëqyrje dhe përgjegjësi nga Drejtori i Mbrojtjes së WV dhe mbështetje nga personi i



kontaktit të mbrojtjes në nivel rajonal. Kur parashikohet nga ligji në fuqi, kërkesat e grantit, ose marrëveshjet me WV, Zyrat Mbeshtetese përkatëse informohen menjëherë në koordinim me WV.

**6.5 Raportimi:** Të gjithë punonjësit dhe personat që janë të angazhuar me WV janë përgjegjës dhe kanë detyrimin të raportojnë çdo dyshim për abuzim në lidhje me fëmijët apo përfitues të rritur (apo cdo shqetësim të tjera lidhur me ruajtjen dhe mbrojtjen, përfshi ndonjë shkelje të kësaj Politike) e cila lidhet me WV apo programet e saj ose që kërkohet nga ligjet e shtetit për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve.

**6.6 Të Bërit Publik/Dalja së jashtmi:** Ndërkohë që WV ruan konfidencialitetin e duhur për individët në lidhje me Incidentet për Ruajtjen dhe Mbrojtjen, WV mund të bëjë publik informacion mbi incidentet, kur lejohet ligjërisht, me qëllim që të mbështesë procesin e hetimit të aktivitetit të dyshuar kriminal, për të përmbushur kërkesat e donatorëve, për të mbështetur të mësuarit dhe llogaridhënien, për të mbështetur parandalimin e incidenteve në të ardhmen, apo sipas kërkesave të ligjit.

Informacioni mbi hetimet që janë në process e sipër të Incidenteve me Ruajtjen dhe Mbrojtjen, si dhe informacioni mbi incidentet e kaluara, ndahet vetëm me personat që kanë realisht nevojë ta dinë ose ta njohin incidentin, siç gjykohet e nevojshme nga Zyra Kombëtare apo Zyra Rajonale apo Njësia për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e WV. Nëse ka gjasa që informacioni sensitiv për të mbijetuarit e incidentit apo për fëmijët e dhunuar nuk do të mbahet konfidencial, dhe do të vinte në rrezik njerëz nëse aksesohet nga palë të paautorizuara, ky informacion nuk grumbullohet.

Informacioni i hollësishëm personal, sidomos informacion shëndetësor, nuk merret ose nuk ruhet nga WV, përveç në minimumin e nevojshëm për të siguruar që WV e trajton çështjen në mënyrën e duhur. Të dhëna të tilla personale mbahen shumë konfidenciale dhe mbrohen në përputhje me standardet përkatëse mbi mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë e informacionit.

**6.7 Raportimi tek Autoritetet:** Komiteti i Ruajtjes dhe Mbrojtjes në WV do të vlerësojë raportimin e shkeljeve të ruajtjes dhe mbrojtjes tek nivelet e duhura të autoriteve ligjore, duke vlerësuar çdo detyrim ligjor për raportim, si dhe interesat e mbijetuesit (-ve). Përgjithësisht, raportimet kryhen, veç rasteve kur një raport gjykohet se ka gjasë të shkaktojë lëndim më të madh ndaj viktimave ekzistuese apo viktimave të ardhshme të mundshme.

## **7.0 Çfarë duhet mbajtur parasysh në Programet në çështje që lidhen me Ruajtjen dhe Mbrojtjen**

**7.1 Çfarë është e domosdoshme kur bën program në lidhje me çështje të ruajtjes dhe mbrojtjes:** Në të gjitha programet që zbatohen në të tria Linjat e Shërbesës (tre shtyllat ku fokusohet puna në WV), WV përpiqet të mos lëndojë fëmijët apo përfituesit e rritur, të mbajë në qendër të veprimtarive të saj interesat e anëtarëve të komuniteteve – sidomos fëmijëve, si dhe të shfrytëzojë mundësitë për të ndihmuar fëmijët që të jenë më të sigurt brenda familjeve dhe komuniteteve të tyre. Kjo përfshin marrjen në konsideratë, gjatë hartimit të programeve, të elementëve që mund të përmbëjnë kërcënim për fëmijët dhe të çështjeve që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve, si dhe ndikimin tek aktorët dhe grupet për të qenë organizata më të sigurta për fëmijët dhe përfituesit e rritur.

### **7.2 Përgjigja e komunitetit dhe mekanizmat për sugjerime dhe/ankesa:**

Fëmijët, prindërit dhe të rriturit e tjerë janë të ndërgjegjshëm për mekanizmat e ankesave në projektete e WV dhe të drejtat e tyre për të qenë të sigurt ndaj abuzimit dhe shfrytëzimit. Cdo nivel i programit të WVA në komunitet:

- a. punon me fëmijë dhe të rritur në komunitet për t'i ndihmuar ata të njohin sjelljen e papërshtatshme nga punonjësit ose bashkëpunëtorët e WV dhe të krijojnë mekanizma të sigurt dhe kontekstualisht të përshtatshëm për reagimin e komunitetit, me anë të të cilave anëtarët e komunitetit mund të raportojnë sugjerime të përgjithshme dhe çdo incident serioz të sjelljes së papërshtatshme nga punonjësit ose bashkëpunëtorët e WVA.
- b. siguron informacione se si të raportoni abuzimin e fëmijëve, shfrytëzimin seksual, ose shkelje të tjera të

Protokolleve të Sjelljes nga punonjësit ose bashkëpunëtorët e WVA në një mënyrë që është në përputhje me ligjin në fuqi.

7.3 Institucionalizimi dhe Adoptimi: WVA nuk e mbështet birësimin e fëmijëve ose të mbështetëse programe afatgjata të cilat synojnë vendosjen e fëmijëve në institucion.

## 8.0 Sponsorship

- 8.1 Parandalimi i Lëndimeve në Sponsorship: Sponsorizimi zbatohet në mënyrë të tillë që ruan sigurinë e fëmijëve si përparësi kryesore. Kjo përfshin shqyrtimin e të gjithë korrespondencës së sponsorëve, trajnimin e personelit dhe monitorëve të fëmijëve për të dalluar dhe përgjigjur ndaj abuzimeve, ndërveprimin konstruktiv me prindër dhe fëmijë, zbatimin e ndërhyrjeve programore për mbrojtjen e fëmijëve, trajtimin dhe magazinimin e sigurt të informacionit personal, dhe grumbullimin vetëm të elementëve minimalë të informacionit personal që është i nevojshëm për programin.
- 8.2 Përgjigja ndaj Abuzimit: Monitorët e fëmijëve në sponsorizime promovojnë veprime apo referime për ndjekjen e duhur lidhur me nëse nevojat për ruajtjen e fëmijëve respektohen apo raportohen, sipas përcaktimeve në Planet kombëtare për Gatishmërinë për Incidentet me Ruajtjen dhe në përputhje me ligjet vendase.

## 9.0 Pjesëmarrja e Sigurt e Fëmijës<sup>17</sup>

9.1 Parandalimi i Lëndimit gjatë Pjesëmarrjes së Fëmijëve në aktivitet: WV punon për të fuqizuar fëmijët si qytetarë dhe pjesëmarrës në mirëqenien e tyre dhe për të minimizuar çdo rrezik për lëndim apo pasojë negative që vjen nga pjesëmarrja në aktivitete të promovuara nga WV. Programet dhe aktivitetet me pjesëmarrjen e fëmijëve bazohen në analizën kontekstuale me nevoja dhe rezultate të pritshme të identifikuara qartë, së bashku me mënyrën se si projekti do të masë përparimin drejt arritjes ndërkohë që ulen rreziqet nëpërmjet vlerëzimit të tyre.

9.2 Etika: Veprimtaritë me pjesëmarrjen e fëmijëve janë ndërtuar dhe zbatuar për t'iu përmbajtur parimeve dhe etikës që mbajnë interesat më të mira të fëmijëve si përparësinë kryesore.

9.3 Pëlqimi i Informuar për Pjesëmarrjen e Fëmijëve në aktivitet: Veprimtaritë me pjesëmarrjen e fëmijëve janë vullnetare dhe përfshirëse (sidomos të fëmijëve më vulnerabël), dhe si fëmijët ashtu edhe prindërit/kujdestarët marrin vendime të informuara lidhur me pjesëmarrjen, përfshi marrjen në konsideratë të përfitimeve dhe rreziqeve që mund të shoqërojnë aktivitetin.

9.4 Udhëtimi i Fëmijëve: Kur është në interesat më të mirë të fëmijëve, WV shpesh herë ndihmon fëmijët të udhëtojnë për në evente, aktivitete apo mundësi të tjera. Në raste të tilla, prindërit apo kujdestarët, si dhe ente apo individë që iu kërkohet ligjërisht, japin pëlqim të informuar përpara udhëtimit. Shëndeti, siguria, mirëqenia dhe pjesëmarrja domethënëse e fëmijëve janë përparësitë më kryesore gjatë udhëtimit të mbështetur nga WV. WV nuk lehtëson vizita të fëmijëve jashtë vendit të tyre për tek sponsori i tyre.

Për marrëveshjen dhe pranimin:

Unë, e kam lexuar, kuptuar dhe jam i/e angazhuar t'i respektoj Protokollin e Sjelljes dhe Politiken e Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Fëmijëve dhe të Rriturve të WVA 2018.

Emri, Mbiemri: \_\_\_\_\_

Firma: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

<sup>17</sup> "Pjesëmarrje e fëmijëve" është një proces i vazhdueshëm i fëmijës dhe respektimi i së drejtës së fëmijës për të shprehur pikëpamjet e veta dhe të dëgjohej në të gjitha nivelet e vendimmarrjes për çështje që lidhen me fëmijët, neni 3/13 Ligji nr. 18/2017.